

PROPOZIM PËR KORNIZËN E KUALIFIKIMEVE KOMBËTARE PËR KOSOVËN

Draft koncepti i propozuar nga grupi i Dublinit

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje

Neni 1	Historiku
Neni 2	Çertifikatat dhe dokumentet tjera shkollore- situata ekzistuese
Neni 3	Kuptimi i kualifikimeve
Neni 4	Arsyeja për themelimin e një Kornize Kombëtare të Kualifikimeve
Neni 5	Llojet dhe nivelet e kualifikimeve
Neni 6	Zhvillimi, zbatimi dhe menaxhimi i KKK
Neni 7	Themelimi i Autoritetit Kosovar të Kualifikimeve
Neni 8	Aranzhimet për miratimin dhe rregullimin e kualifikimeve
Neni 9	Aranzhimet për dhënien e certifikatave për kualifikimet dhe sig. e cilësisë.
Neni 10	Dimensioni i BE-së dhe ndërkombëtar

Aneksi 1 Anëtarët e Grupit të Dublinit

Aneksi 2 Workshop-i konsultues i palëve të interesuara të KKK

Përmbledhje

Në takimin ndërkombëtar më 21 janar 2005, të organizuar nga Fondacioni Evropian për trajnime (ETF) në Torino, vendet e Evropës juglindore kanë këmbyer informata, se si secili vend mund të përfshihet në politikat dhe praktikat e BE-së në arsimin dhe trajnimin profesional në vendet përkatëse duke zbatuar procesin e Kopenhagës. Në këtë takim, Kosova, u dha rëndësi të madhe çështjeve të Kopenhagës, ku si prioritet u zgjodhën kualifikimet profesionale për të cilat do të themelohet një kornizë institucionale për kualifikime më të gjera në Kosovë me referencë të një përfshirjeje të mësimit tërë jetësor. Një grup i zyrtarëve vendor dhe ekspertëve nga institucione të ndryshme të kyçura të cilët ishin në Dablin (grupi i Dablinit) zhvilluan idenë dhe opcionet për zhvillimin e një politike institucionale të kualifikimeve në Kosovë.

Hartimi i këtij dokument është si rezultat i një dialogu intensiv, reflektimit dhe procesit për planifikim nga grupi i Dublinit (i përbërë nga autoritetet shtetërore, partnerëve social dhe institucioneve shoqërore civile). Grupi i Dublinit ka pasur mbështetje teknike dhe financiare nga ETF, (Fondacioni Evropian për Trajnime), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) dhe Organizatës për Siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE). Anëtarësimi i grupit është paraqitur në shtojcën 1.

Procesi i zhvillimit të dokumentit ka përfshirë një seri takimesh dhe trajnimesh në Kosovë dhe vizitën studimore në Irlandë. Konkluzionet përfundimtare janë nxjerr bashkarisht nga grupi të cilët kanë diskutuar me personelin e lartë kyçës nga organizatat e kyçura dhe në bazë të mendimeve të paraqitura konsiderohet se ata përfaqësojnë një konsensus të gjerë të mendimeve sa i përket këtyre çështjeve, brengave dhe opcioneve për zhvillimin e kualifikimeve profesionale dhe një kornizë kombëtare të kualifikimeve në Kosovë. Ne konsiderojmë se rekomandimet në këtë dokument do të sigurojnë baza mbi aplikimin e deklaratës së Kopenhagës të BE-së në Kosovë, dhe po qe se zhvillohet më tepër, do të përfaqësojë një hap të rëndësishëm drejt integritimit Evropian.

Propozimet në këtë dokument janë vlerësuar përmes prezentimit dhe diskutimit të një seminari të palëve të interesuara e organizuar nga MASHT, mbajtur në villa "Gërmia" në Prishtinë, më 13 korrik 2005. Të pranishëm në këtë seminar ishin mëse 30 pjesëmarrës, përfshirë këtu edhe përfaqësues të lartë të MASHT-it, Ministrive tjera dhe organizatave kyçëse të ndërlidhura me këtë çështje. Një listë e personave të cilët kanë marrë pjesë në këtë seminar është dhënë në shtojcën 2.

Konkluzionet kryesore të arritura në diskutim të këtij seminari janë si në vijim:

1. Njohja e gjerë e një kornizë të kualifikimeve kombëtare e cila përfshin të gjitha llojet e arsimit dhe aftësimin që do të ofrojnë qasje të politikave koherente kombëtare për zhvillimin dhe njohjen e kualifikimeve, dhe një kornize transparente që do të mbështet mësimin tërëjetësor dhe të krahasoj me ato të bashkësisë ndërkombëtare.
2. Koncepti i KKK mbështetet nga njerëzit e një nivel të lartë të ministrive përkatëse, organizatave , partnerëve social dhe asamblesë në Kuvend.
3. Do të fillohet me hartimin e ligjit për themelimin e Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare (KKK) dhe strukturat institucionale për zbatimin e saj.
4. Ligji do të sigurojë që themelimi i Autoritetit për kualifikime në Kosovë(AKK), do të jetë në përputhje me dispozitat për themelimin e agjencive ekzekutive të specifikuara në nenin 3 Rregullorja 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve Vetëqeverisëse në Kosovë.
5. AKK duhet të themelohet si një organ autonom dhe vendimmarrës, në të cilën strukturë do të përfshihen ekspertë nga ministrinë përkatëse, organizatat partnere shoqërore dhe palëve të tjera të interesuara.
6. Komisioni për arsim dhe kulturë i Kuvendit të Kosovës mund të iniciojë përpilimin e legjislacionit të nevojshëm përmes një procesi me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara përkatëse.

Përmbajtja e këtij dokumenti është modifikuar ,në mënyrë që të merr parasysh komentet në seminarin konsultativ mbi aspektet specifike të konceptit.

Neni 1

Historiku

Sistemi i arsimit dhe aftësimit në Kosovë ka evoluar gjatë 3 periudhave:

- Periudha e arsimit gjatë ish-Jugosllavisë prej vitit 1945 deri më 1989, gjatë së cilës është kërkuar që sistemi i arsimit në Kosovë të drejtohet sipas kërkesave të centralizuara të shtetit, derisa ato gjithnjë e më shumë ngecnin.
- Në periudhën e shkatërrimit të Jugosllavisë prej vitit 1989 e deri në luftën e 1999, gjatë së cilës shumica e popullsisë së Kosovës ishte e detyruar të punojë në një sistem “paralel” për shkak të rrethanave, derisa kanë qenë të përjashtuar nga ofrimi i arsimit nga shteti.
- Periudha e rindërtimit që nga lufta e vitit 1999, gjatë së cilës Kosova ka qenë në gjendje të fillojë të zhvillojë një sistem të ri në linjë me nevojat e shfaqura të popullsisë si dhe duke marrë parasysh sistemet e shteteve evropiane.

Është e qartë se Kosova para vitit 1989, ka pasur një strukturë institucionale, e aftë për të ofruar pak përkrahje të kualifikuar për zhvillimin e sistemit të arsimit, i cili nuk është më duke funksionuar. Aktualisht, njëra nga sfidat më të mëdha është zhvillimi i një strukture të re institucionale, e aftë të përkrahë reformat e nevojshme për t’iu përshtatur situatës së re. Fusha e kualifikimeve është një fushë e tillë, e cila po bëhet gjithnjë e më shumë e rëndësishme përdërisa Kosova po lëvizë drejtë integritimeve të mëdha në rrjedhat e zhvillimit të sistemeve evropiane të arsimit.

Çertifikimi ekzistues për arsimin fillor, të mesëm, profesional dhe për arsimin e të rriturve, është bërë nga ana e ofruesve të arsimit dhe aftësimit formal që ka vepruar sipas rregullimeve të MASHT-it. Nuk ekziston ndonjë rregullim i standardizuar për vlerësim apo sigurim të cilësisë së çertifikimit nga jashtë që mbulon ndonjë pjesë të sistemit. Çertifikatat e lëshuara nga institucionet që nuk janë të licencuara nga MASHT-i, p.sh qendrat e aftësimit profesional të MPMS dhe nga ofruesit joformal nuk njihen aktualisht.

Megjithëse ETF dhe Danida, gjatë vitit 2002/04, kanë bërë përpjekje të themelojnë një sistem të ri të çertifikimit profesional duke ofruar rregullime të përbashkëta për tu zbatuar si për ofruesit formal ashtu edhe për ata joformal të AAP, prapë se prapë rregullimet institucionale tripalëshe dhe rregullimet tjera të propozuara nuk janë pranuar nga të gjithë. Një Këshill Kombëtar për Shkathtësi është propozuar dhe janë bërë emërtimet nga ana e MPMS, MTI dhe partnerëve social por jo edhe nga MASHT-i. Mospjesëmarrja e MASHT-it ndoshta ka qenë pengesa kryesore nga fakti se funksionet e propozuara ishin jashtëzakonisht të zgjeruara, duke mbuluar aktivitete rregulluese, të cilat kanë shkuar shumë më larg se çertifikimi dhe dhënia e kualifikimeve nga ana e Këshillit Kombëtar të Shkathtësive. Megjithatë, duhet të dihet se janë bërë disa eksperimente me themelimin e komiteteve të standardeve profesionale në bazë ad hoc dhe pilot, të cilat kanë qenë të përkrahura nga të gjithë bartësit, duke përfshirë këtu edhe MASHT-in.

Ligjet ekzistuese në fuqi janë: Ligji për Arsimin Fillor dhe të Mesëm , Ligji për Arsimin e Lartë dhe Ligji mbi Arsimin dhe Aftësimin për të rritur. Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, është aktualisht në Parlament.. Dy ligjet e fundit përfshijnë dispozitat për qasje në vlerësim që merr parasysh mësimin paraprak. Nuk ekziston asnjë ligj për kualifikimet dhe programi aktual legjislativ i Qeverisë nuk ofron dispozita për një ligj të tillë dhe si rezultat çështjet e çertifikimit nuk janë duke u trajtuar në mënyrë sistematike. Megjithatë, projektligji për AAP nuk ofron dispozitën fillestare për një kornizë, që do të mbulonte kualifikimet profesionale.

Sistemi i arsimit formal e konsideron si prioritet, çertifikimin e njohurive dhe shkathtësive të fituara nga të kthyerit dhe atyre jashtë vendit. Për një lejim të tillë tashmë ekzistojnë rregullimet për parimet kur kanë të bëjnë me qasjen në provimet për nxënësit e “parregullt”. P.sh. për ata të cilët nuk kanë marrë pjesë në kurset e organizuara nga sistemi formal.

Projektligji mbi AAP ballafaqohet me themelimin e një organi trepalësh këshilldhënës dhe konsultativ, Këshilli për AAP, i cili do të luajë rolin ndihmës për formulimin e politikave për tërë sektorin e AAP. Funkcionet e tij mund të përfshijnë dhënien e rekomandimeve mbi standardet, kurrikulat dhe kualifikimet për t'i përmbushur nevojat e sektoreve të veçanta, por funksioni ekzekutiv nuk është parashikuar.

Megjithëse janë paraparë të themelohen institucione tjera, siç janë Këshilli për aprovimin e kurrikulave dhe teksteve shkollore (i cili është paraparë të ketë përgjegjësi posaçërisht në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët) dhe Agjencioni Kosovar i Akreditimit (i cili licencën institucionet e arsimit të lartë), duket se ata nuk kanë ndonjë rol lidhur me kualifikimet. Për këtë arsye, debatet për kualifikimet vijnë kryesisht nga sektori i AAP se sa nga arsimit i përgjithshëm.

Themelimi i sistemit të kualifikimeve kombëtare dhe korniza në Kosovë është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit për ta bërë sektorin e arsimit dhe trajnimit sa më transparent dhe të hapur në ekonomi të vendit, ndërsa në të njëjtën kohë, duke i dhënë bashkëpunim midis punëdhënësve dhe institucioneve të arsimit dhe trajnimit, marrëveshje për prezentimin e KKK në Kosovë do të ndihmojë për ta bërë fuqinë punëtorë konkurruese dhe për ta siguruar që standardet janë të krahasueshme në tregun rajonal dhe Evropian.

Neni 2 Certifikatat dhe dokumentet tjera shkollore – situata ekzistuese

Programet e arsimit parashkollor, fillor, të mesëm dhe të arsimit të lartë në Kosovë, janë klasifikuar sipas niveleve të SNKA (Standardet Ndërkombëtare për Klasifikimin e Arsimit) ISCED. Certifikatat apo dokumentet tjera shkollore jepen me kompletimin e kërkesave për arritjen e niveleve të arsimit dhe aftësisht (megjithëse këto nuk duhet të ngatërrohen me nivelet e kualifikimeve). Prej arsimit të mesëm të ulët (faza përfundimtare e arsimit të detyrueshëm) e më tutje, rregullimet ekzistuese janë si në vijim:

Niveli II i ISCED:

Dokumentet shkollore (dëftesat) jepen në fund të çdo viti akademik, gjatë arsimit të mesëm të ulët (faza e dytë e arsimit bazë, klasa e VI, VII, VIII, IX që zakonisht përfshin moshën prej 12 – 15 vjeç). Të gjithë nxënësit hyjnë në testin e obligueshëm në fund të klasës së IX-të, që përdoret si kriter i përzgjedhjes për arsimimin e mëtejshëm. Megjithatë nuk jepet certifikata mbi ndonjë kualifikim për ata që e kanë kryer arsimin e obligueshëm.

Niveli i III i ISCED:

Rregullimet në vijim zbatohen për të gjithë nxënësit që vijojnë shkollimin e mesëm në gjimnaze apo shkollat e mesme profesionale:

- Arsimit të mesëm të lartë do të jetë tri ose katër vjet, sipas programeve arsimore të përcaktuara nga MASHT-i (zakonisht prej moshës 15-19 vjeç). Dokumentet shkollore (dëftesat) jepen në fund të çdo viti akademik (klasa X, XI, XII dhe XIII).

Rregullimet plotësuese si në vijim zbatohen për nxënësit e arsimit profesional (programet në vijim të klasifikuara sipas niveleve të ISCED-it nivelet 3A, dhe/ose 3C¹):

- Certifikata e arsimit profesional u jepet nxënësve, që e lënë arsimin profesional pas përfundimit të suksesshëm të klasës së XI –të (që paraqet arritjen e kërkesave bazë për hyrje në tregun e punës si punëtorë të gjysmëkualifikuar).
- Certifikata e arsimit profesional dhe diploma e titullit profesional (si punëtor i kualifikuar) u jepet atyre që dalin nga shkollat profesionale pas përfundimit të suksesshëm të klasës së XII –të
- Diploma e maturës u jepet atyre që kryejnë shkollat profesionale pas përfundimit të suksesshëm të klasës së XIII-të me provimin përfundimtar. Matura i përmbush kërkesat bazë për hyrje në arsimin e lartë.

Rregullimet si në vijim zbatohen për nxënësit e arsimit të përgjithshëm (niveli 3A të ISCED):

- Programet e arsimit të përgjithshëm, të mesëm të lartë (gjimnazi) janë ose 3 ose 4 vjet sa i përket kohëzgjatjes. Me përfundimin e programit (në klasën e XII-të ose XIII-të), nxënësit hyjnë në provimin përfundimtar për diplomën e Maturës, që i përmbush kërkesat bazë për hyrjen në arsimin e lartë.

Niveli i IV i ISCED

Ky nivel ofron 2 nivele tjera, të cilat aktualisht vetëm një pjesë e saj mbulohet në sistemin e arsimit dhe aftësimit në Kosovë:

- ISCED 4B siguron programet post-sekondare ose aftësimin për të rritur, që qojnë drejtpërdrejtë në tregun e punës. Ato nuk kanë nevojë të jenë të nivelit më të lartë sesa ISCED 3 dhe nxënësit e “parregullt” janë të aftë të hyjnë në provimet që ofrohen në programet e mesme të larta pa i

¹ Programet e Niveli 3B të ISCED (tentojnë t’i përparojnë programet e ISCED të nivelit 4A) të cilat nuk ekzistojnë për momentin për shkak të mungesës së ekzistimit në tërësi të nivelit 4A të ISCED.

përbushur kërkesat normale të vijimit të mësimin për nxënësit e rregullt. Shumica e kurseve për aftësimin e të rriturve (p.sh. të MPMS) nuk i përbushin kërkesat për ISCED 3B, sepse janë më të shkurtëra se gjashtë muaj në kohëzgjatje dhe për këtë janë të paklasifikuara.

- Tradicionalisht, sistemi i arsimit në Kosovë ofronte kurse të larta profesionale 2- vjeçare në shkollat e larta teknike dhe shkollat e larta ekonomike. Këto kurse nuk ekzistojnë më (sepse institucionet në fjalët tash klasifikohen si fakultete të universitetit, që ofrojnë programe 3 – vjeçare (bachelor), megjithëse ende e kanë bazën ligjore. Nëse do të ekzistonin ato do të klasifikoheshin në nivelin 4A të sistemit të ISCED-it. Kjo është një zbrazëtim e madhe në sistemin e tanishëm, sepse Kosova nuk e ka nivelin e teknikut që është ekuivalent me shumicën e shteteve të BE.

Niveli i V i ISCED:

Ky mbulon dy nivele të arsimit universitar:

- Diploma (bachelor)
- Magjistratura

Niveli i VI i ISCED:

Ky mbulon nivelin për hulumtime shkencore në nivelin e Doktoraturës

Në sektorin publik, certifikatat jepen nga ofruesit e arsimit, që punojnë nën rregullimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Nuk ekziston ndonjë sistem i barasvlerës ose njohjes së certifikatave të sektorit privat ose të ofruesve joformal, të cilat nuk njihen në kohën aktuale. Certifikatat e MPMS paraqesin arritjet e moduleve të bazuara në shkathtësi dhe kompetencë, të fituara nëpërmjet kurseve kryesisht 3-mujore (por nganjëherë edhe 6 – mujore), që janë të lidhura në mënyrë jo të drejtpërdrejt me pjesët praktike të kurrikulit profesional të MASHT-it që ka tendenca të jetë e orientuar drejt një qasje më tepër teorike.

Siç është vërejtur në nenin 1 më lartë, janë duke u themeluar rregullimet për t’iu ofruar të rriturve që nuk i përcjellin programet e rregullta të arsimit të lartë të mesëm mundësi për vlerësim dhe certifikim mbi baza të arsimit paraprak dhe të të arriturave.

Neni 3

Kuptimi i kualifikimeve

Kualifikimi paraqet certifikim formal, të dhënë nga autoriteti përgjegjës, që dëshmon të arriturat dhe mësimin e një individi në pajtim me aspektin profesional, kërkesat e industrisë ose të shoqërisë. Megjithatë, sistemi i kualifikimeve është më shumë sesa thjeshtë dhënia e certifikatave.

Kualifikimi merret nëpërmjet një procesi të bazuar mbi një numër komponentësh, ku më të rëndësishmet nga to janë standardet, vlerësimi dhe certifikimi. Kjo nuk është vetëm çështje e inspektimit – ekziston edhe nevoja për të siguruar se rezultatet e mësimit vlerësohen në mënyrë të pajtueshme sipas standardeve që kërkohen.

Kompetenca e individit sigurohet nga vlerësimi i njohurive, shkathtësive dhe shprehive sipas standardeve të definuara. Ka mundësi që, me zgjerimin e mundësive të mësimit për të rritur, do të ketë shumëllojshmëri më të madhe të programeve të mësimit (kohëzgjatje të ndryshme, përmbajtje të ndryshme etj.) prandaj në të ardhmen do të vendoset një theks më i madh në standardizimin e rezultateve të mësimit.

Një shoqëri post-komuniste në tranzicion, sikurse Kosova duhet t'i ikë përsëritjes të sistemeve të stër-centralizuara të së kaluarës. Krijimi i mundësive për mësimin gjatë gjithë jetës për të gjithë, kërkon një qasje fleksibile tek realizimi i programit. Megjithëse korniza e kualifikimeve për kualifikime, përfshin një nivel të caktuar të centralizimit, është e rëndësishme të thuhet se standardizimi i vlerësimit dhe certifikimit hap rrugën tek realizimi i decentralizuar i programit dhe zhvillimin e një sistemi mësimor më fleksibil dhe të shumëllojshëm.

Standardizimi do të jetë në nivelin e rezultateve të mësimit dhe certifikimit dhe jo si është realizuar mësimi. Individi nuk ka nevojë të ndjekë një rrugë të vetme të mësimit për të arritur kërkesat e domosdoshme për certifikimin e të arriturave sesa si realizohet mësimi. Në periudha më të gjata, KKK duhet të jetë mjet për arritjen e një fleksibiliteti dhe shumëllojshmërie më të madhe të sistemit sesa anasjelltas. Kriteret dhe kërkesat duhet të hartohen duke pasur këtë objektiv në mendje.

Neni 4

Arsyeja për themelimin e një Kornize Kombëtare të Kualifikimeve

Themelimi i një Kornize Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) shikohet gjerësisht si një parakusht vital për arritjen e objektivave kryesore strategjike të sistemit të arsimit dhe aftësimin me:

- Lehtësimin e vazhdimsisë dhe kryerjen e arsimit elementar dhe reformave në aftësim, dhe të sigurojë kredibilitet dhe qëndrueshmëri të atyre reformave;
- Përmirësimin e cilësisë dhe ngritjen e fleksibilitetit në arsim dhe aftësim;
- Ofrimin e një kornize transparente dhe gjithëpërfshirëse për të përkrahur zhvillimin e mësimit gjatë gjithë jetës në Kosovë;
- Ofrimin e katalizatorit për stimulimin e zhvillimit të standardeve dhe përshtatjen e kualifikimeve për ti përmbushur nevojat e individëve dhe bizneseve;

KKK do të ofrojë një fokus për:

- Caktimin e kërkesave dhe niveleve të kualifikimeve për certifikimin e të arriturave;
- Ofrimin e një fokusi për zhvillimin e standardeve të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave;
- Ofrimin e një baze për bashkëpunim dhe krahasim në mes të pjesëve të ndryshme të sistemit të arsimit dhe aftësimin profesional;
- Përkrahjen e përparimit të nxënësve nëpërmjet të sistemit të arsimit dhe aftësimin profesional;
- Përmirësimin e punësueshmërisë së atyre që hyjnë në tregun e punës;

- Promovimin e arsimit të mëtejshëm dhe aftësimin, përfshirë kornizën për zhvillimin e mësimin gjatë gjithë jetës dhe vazhdimin e zhvillimit të shkathtësive për të rritur.

Mbi të gjitha KKK do të ofrojë transparencë më të madhe. p.sh. ajo do të ketë për qëllim që ta bëjë më të qartë relevancën e kualifikimeve profesionale me vendet e punës dhe kërkesat e punësimit dhe duke bërë këtë do të kontribuojë në përmbushjen e kërkesave të punëdhënësit dhe përkrah zhvillimin ekonomik. Punëdhësit do të jenë në gjendje t'i përdorin informatat lidhur me kualifikimet në një mënyrë më të informuar kur rekrutojnë personelin duke u siguruar se fuqia punëtore është e kualifikuar të punojë në standarde cilësore. Korniza duhet të ofrojë një fokus për udhëheqjen e zhvillimit të arsimit të drejtuar më tepër sipas kërkesave dhe programeve të aftësimin. KKK do t'i ndihmojë nxënësit, trajnerët dhe vijuesit tjerë për të marrë vendime lidhur me kualifikimet që ata kanë nevojë, duke mundësuar krahasimet nëpërmes niveleve të ndryshme dhe identifikimin e përparimit dhe orientimit drejt karrierës.

Rëndësia themelore e KKK (Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) do të jetë si një "mbrellë" për AAP, me një konsensus se do të jetë e pranueshme nga të gjitha palët e interesuara, të përfshira në sistem. Korniza do të përfshijë tërë sistemin e AAP, së bashku me gjithë format e tjera të mësimin për të rinj dhe të rritur, brenda institucioneve të MASHT-it , qendrave për aftësim formal dhe joformal e gjithashtu edhe arsimin e lartë.

Zgjerimi i BE me përfshirjen e shteteve kandidate do të kërkojnë një ushtrim të parimit për lëvizjen e lirë të forcës punëtore dhe ndryshimet e tjera, që do të bëheshin të mundura në njohjen ndërkombëtare të kualifikimeve. Kjo do të kërkojë kornizë transparente të kualifikimeve

Neni 5 Llojet dhe nivelet e kualifikimeve

Projektligji për AAP propozon një kornizë të kualifikimeve profesionale. Kjo mund të jetë hapi i parë drejt një KKK të përgjithshme. Megjithatë, ekziston nevoja të ecim drejt një kornize gjithëpërfshirëse që i mbulon të gjitha kualifikimet. Sidoqoftë mund të ketë vështirësi në kohën e tanishme në përfshirjen e kualifikimeve të universitetit. Për këtë arsye një hap i menjëhershëm mund të bëhet përpara nëse do t'i përfshijmë të gjitha kualifikimet e arsimit të përgjithshëm dhe profesional jouniversitar kurse kualifikimet universitare të lihen për më vonë. Megjithatë, duhet të bëhen angazhime që, KKK në periudhë më të gjatë duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë aty kualifikimet e arsimit të përgjithshëm, profesional dhe të lartë.

Më poshtë, sa i përket nivelit të arsimit të lartë, grupi ka identifikuar këto lloje të kualifikimeve:

- Certifikatat që normalisht janë fituar nga programet brenda sistemit të arsimit formal. Ato mund të vërtetojnë të arriturat e arsimit të përgjithshëm apo arsimin profesional. Në disa raste, këto kualifikime mund t'i marrin edhe "nxënësit jo të rregullt" të cilët nuk i kanë vijuar programet e sistemit të arsimit formal;
- Certifikatat e fituara nga kurset jashtë sistemit të arsimit formal, kryesisht kurse të shkurtëra të aftësimin, që shpesh organizohen mbi baza modulare.

Është e qartë se, rregullimet e vlerësimit dhe certifikimit në sistemin e arsimit formal janë përgjegjësi e MASHT-it, me kërkesat elementare që janë definuar në ligje të ndryshme mbi arsimin dhe aftësimin si dhe rregullime më të detajuara që rregullohen me udhëzime administrative që nxirren kohë pas kohe nga MASHT-i. Kërkesat dhe përkufizimet për kualifikim jashtë sektorit të arsimit formal janë rregulluar në një farë mase nëpërmes rregullimeve për licencimin e ofruesve të arsimit dhe aftësimin, e po ashtu është e qartë se rregullimet e tilla nuk janë complete dhe është vështirë se çdo formë e arsimit dhe aftësimin jo-formal do të mbulohet me një sistem gjithëpërfshirës të licencimit. Grupi konsideron se përcaktimi i kriterëve të qarta dhe rregullimeve për vlerësim dhe certifikim të mësimin joformal, do të kërkojë konsultime dhe diskutime të konsiderueshme në mes të bartësve. Megjithatë, KKK do të ketë nevojë të njohë laramanin e mësimin joformal.

Nivelet e kualifikimeve në Kosovë, nuk janë të përcaktuara ende, megjithëse sistemi ekzistues i certifikimit i nënkupton së paku 8 nivele. Grupi ka vërejtur se BE është duke përshtatur kornizën me 8 nivele (e bashkangjitur në shtojcën 2), si një formë për të krahasuar nivelet e kualifikimit në shtete të ndryshme dhe konsideron se nivelet në Kosovë duhet të jenë në linjë me ato të BE, sa më shumë që është e mundur për t'i pasur si bazë për një afat më të gjatë dhe ekuivalent me to.

Për momentin, grupi ka konsideruar përdorimin e 5 niveleve të aftësisë profesionale të BE (e bashkangjitur në shtojcën 1) plus 3 nivelet e arsimit të lartë si bazë e përkohshme për caktimin e 8 niveleve. Megjithëse nivelet e aftësisë të BE nuk krahasohen në mënyrë të mjaftueshme me nivelet e ekzistues të certifikimit në Kosovë siç duket, diploma e maturës pa dyshim do të jetë e barabartë me nivelin e 4 të KKK (më tepër sesa në nivelin e 3 të niveleve të BE). Një pyetje tjetër që është adresuar është ajo lidhur me nevojën për një certifikim që do të jepet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm (p.sh. pas klasës së IX) si nivel i parë i KKK. Kualifikimet më lartë se niveli i 3, ende duhet të përcaktohen më saktë në kontekst me nevojën për zhvillimin e kualifikimeve post-sekondare dhe joterciare në të ardhmen. P.sh. a duhet të jetë vetëm një nivel i kualifikimeve post-sekondare dhe joterciare apo dy dhe se a ekzistojnë vetëm 3 nivele të kualifikimeve të arsimit të lartë apo duhet të jenë më tepër?

Në vazhdim e kemi propozimin e grupit për një kornizë të përkohshme e bazuar në kualifikimet ekzistuese apo të planifikuara si hap i parë drejt zhvillimit të KKK afatgjatë në Kosovë.

Figura 1: Propozimi i përkohshëm i KKK

Opsioni 1

Nivelet e KKK	FORMALE		JOFORMALE		Nivelet ISCED
	Të përgjithshme	Profesionale			
8	Shkalla e Doktoraturës				VI
7	Shkalla e Magjistraturës				V
6	Shkalla Bachelor				V
5		Diploma e arsimit të lartë profesional (teknik)	Certifikata mbi kurse shkurtra apo certifikatat modulare		IVA
4	Diploma e Maturës (Arsimi i përgjithshëm)	Diploma e maturës (Arsimi profesional)			III A apo B
3		Certifikata e arsimit profesional (Punëtor i kualifikuar)	Certifikata mbi kurse të shkurtra apo modulare		III C IV B
2		Certifikata e arsimit profesional (Punëtor gjysmë i kualifikuar)	Certifikata mbi kurse të shkurtra apo modulare		IIIC IVB
1	Certifikata e mbarimit (arsimi i detyrueshëm)		Certifikata që merret për shkathësitë elementare Kurse të shkurtra		II IVB

Kuititë e hijezuara tregojnë mungesat e përkohshme të cilat mund të plotësohen apo jo në një afat më të gjatë

Opsioni 2

Nivelet e KKK	FORMALE		JOFORMALE		Nivelet ISCED
	Të përgjithshme	Profesionale			
8	Shkalla e Doktoraturës				VI
7	Shkalla e Magjistraturës				V
6	Shkalla Bachelor				V
5		Diploma e arsimit të lartë profesional (teknik)	Certifikata mbi kurse të shkurtra apo certifikatat modulare		IVA
4	Diploma e Maturës (Arsimi i përgjithshëm)	Diploma e maturës (Arsimi profesional)			III A apo B
3		Certifikata e arsimit profesional (Punëtor i kualifikuar)	Certifikata mbi kurse të shkurtra apo modulare		III C IV B
2		Certifikata e arsimit profesional (Punëtor gjysmë i kualifikuar)	Certifikata mbi kurse të shkurtra apo modulare		IIIC IVB
1	Certifikata e mbarimit (arsimi i detyrueshëm)		Certifikata që merret për shkathtësitë elementare Kurse të shkurtra		II IVB

Kutitë e hijezuara tregojnë mungesat e përkohshme të cilat mund të plotësohen apo jo në një afat më të gjatë

Neni 6

Zhvillimi, zbatimi dhe menaxhimi i KKK

Si duhet të paraqitet KKK? Është e qartë se do të jetë i nevojshëm një ligj i ri për kualifikime. Udhëheqja duhet të merret nga MASHT-i, por procesi i zhvillimit duhet të jetë gjithëpërfshirës, që do të përfshinte MPMS dhe ministritë e tjera, partnerët shoqëror dhe palët e tjera me interes, përfshirë arsimin e lartë dhe intereset profesionale. Megjithatë plani paraprak i ministrisë përfshin zhvillimin e mëtejshëm të legjislationit, themelimi i një KKK nuk është njëra nga fushat e propozuara aktualisht dhe kjo është një çështje, e cila duhet urgjentisht të adresohet nga ministria.

Grupi ka marrë në konsiderim nëse zhvillimin dhe implementimin e KKK do t'a menaxhojë direkt MASHT-i. Meqenëse MASHT-i ka nevojë të mbajë përgjegjësitë për politikën e përgjithshme mbi kualifikimet, por grupi konsideron se, nuk është e përshtatshme që ministria si e vetme të menaxhojë dhe implementojë procesin. Kjo është për shkak se besueshmëria e sistemit do të varet nga arritja e zotimit sa më të gjerë të bartësve mbi tërë KKK. Kjo do të jetë e vështirë, nëse jo e pamundur, që të arrihet nëse KKK është e paraparë apo e konsideruar si një instrument i veçantë brenda qeverisë.

Rregullimet institucionale të KKK do të kenë nevojë që të jenë gjithëpërfshirës në pikëpamje të pjesëmarrjes së bartësve, dhe qeverisja e KKK do të ketë parasysh nevojën që të përfshijë një varg interesash siç janë organizatat e punëdhënësve, interesat e arsimit të lartë dhe sektorit privat në planifikimin dhe implementimin e kornizës.

Në bazë të përvojave ndërkombëtare që janë vrojtuar (p.sh. në Irlandë), do të ekzistojë nevoja të themelohet një organ i pavarur i kualifikimeve, i cili përkohësisht do të jetë i emëruar si Autoriteti Kosovar për Kualifikime (AKK). Ky organ duhet të jetë fokus i të gjitha zhvillimeve të sistemit të kualifikimeve në Kosovë dhe një katalizator për reformën. AKK duhet të caktojë kriteret për zhvillim, aprovim dhe rregullim të kualifikimeve dhe të dizajnojë dhe zbatojë kornizën e përgjithshme të kualifikimeve

Në përgjithësi, Kosova duhet t'i shmanget zhvillimit të strukturave institucionale shumë komplekse dhe është e mundur që strukturat e zhvilluara institucionale të jenë më të thjeshta sesa strukturat e vrojtura në Irlandë, ku ekzistojnë organe të veçanta për dhënien e kualifikimeve (FETAC dhe HETAC) dhe t'i rregullojnë ato (NQAI). Në parim, Kosova duhet të ketë synim një sistem, që do të jetë fleksibil dhe i decentralizuar aq sa është e mundur dhe të merr parasysh se ligji për arsim dhe aftësim në përgjithësi kujdeset për organizatat, që ofrojnë programe të mësimi për lëshimin e certifikatave. Për të ndryshuar kjo situatë do të nevojiten amendamente tek legjislacionet e tjera dhe, për këtë arsye, rekomandohet që roli AKK duhet të jetë të aprovojë kualifikimet dhe miratojë sesa që t'i japë ato.

Në çdo rast, situata financiare e Kosovës nuk do të lejojë krijimin e më shumë se një organi të ri të kualifikimeve dhe me gjasë funksionet e shumta, që janë të përfshira në themelimin dhe menaxhimin e sistemit të kualifikimit duhet të përfshihet në kuadër të atij organi. Në çdo rast, është një ekspertizë e kufizuar njerëzore për tu tërhequr në kohën aktuale dhe do të parapëlqejë që ekspertizën e tillë ta koncentrojmë brenda një institucioni të vetëm sesa ta udhëheqim rrezikun e defragmentimit duke i shpërndarë individët në fjalë përgjatë një numri më të madh të institucioneve.

Për kualifikimet profesionale, AKK është e nevojshme të udhëhiqet nga rekomandimet e Këshillit të propozuar për AAP, të paraparë në Projektligj të AAP. Për shembull, KAAP duhet të këshillojë për a) strukturën e kualifikimeve profesionale për çdo sektor dhe b) kërkesat për kualifikimet e veçanta duke u bazuar në nevojat e tregut të punës. A duhet Komisioni Kombëtar për Kurrikula dhe Tekste Shkollore të ketë të njëjtin rol edhe për kualifikimet e arsimit të përgjithshëm? Dhe çka sa i përket arsimit të lartë? Duhet të jemi shumë të kujdesshëm rreth asaj se si definohen marrëdhëniet e AKK në lidhje me të dy ministritë dhe institucioneve të tjera.

Radha e bartësve, të cilët duhet të përfshihen në punën e AKK, përfshin qeverinë e Kosovës (MASHT, MPMS, MTI, MRKS, MEF, etj.), Partnerët Shoqëror, (BSPK, OEK) dhe Shoqëria Civile (OJQ-të) etj. Strategjitë duhet të punohen nga qeveria në bashkëpunim me Komisionin për Arsim të Parlamentit, në atë mënyrë që optimizon mundësitë për debat publik dhe bazohet në konsensus të gjerë midis të gjitha palëve të interesuara.

Nëse AKK do të ishte përgjegjës vetëm për kualifikimet profesionale, mund të ishte një organ trepalësh sikurse KAAP, ose madje edhe si pjesë e strukturës së KAAP. Sidoqoftë, kjo nuk do të jetë e mundur nëse është përgjegjës gjithashtu edhe për kualifikimet e arsimit të përgjithshëm dhe të lartë dhe aranzhimet e qeverisjes duhet të jenë më të gjera, duke inkorporuar organet profesionale dhe interesat e arsimit përfshirë edhe atë të universitetit.

Koncepti tashmë i zhvilluar në projektin paraparak të certifikimit ka paraparë një strukturë, në të cilën një numër i organeve të nënrenditura do të jenë përgjegjëse për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve profesionale. Në atë koncept, do të ekzistojnë një numër i komiteteve të standardeve profesionale për sektor (KSP), që do të raportojë tek Këshilli Kombëtar për Shkathtësi. Me gjasë se ideja e KKSH tash është zëvendësuar me AKK dhe KAAP dhe çështje mbetet nëse KSP duhet të raportojnë tash tek AKK ose tek KAAP? Çështje do të mbetet se kush do të zhvillojë standardet për kualifikimet e arsimit profesional, megjithëse përgjegjësia e përgjithshme duhet të mbetet me MASHT-in.

Duke e pasur parasysh faktin se KKK ka për qëllim të mbulojë të gjitha llojet e kualifikimeve, është e qartë se përgjegjësitë e KKK duhet të jenë të ndryshme prej atyre që më herët janë paraparë për Këshillin Kombëtar të Shkathtësive dhe se do të jetë e nevojshme të ridefinojmë përgjegjësitë e ndryshme të të gjitha organizatave që do të luajnë rol në themelimin dhe zbatimin e KKK. Lidhur me këtë pyetje, grupi propozon që:

1. Përgjegjësitë e MASHT-it do të jenë:


- Të themelojë dhe pjesërisht financojë KKK, dhe do të veprojë sipas marrëveshjes në mes të MPMS dhe ministrive tjera përkatëse;
- Të përcaktojë kornizën e përgjithshme të politikës për zhvillimin e kualifikimeve;
- Të nxjerrë udhëzime administrative për implementim;

- Të pranojë raporte dhe shqyrtojë në mënyrë periodike.
2. Përgjegjësitë e KAAP dhe organeve tjera ekuivalente këshillëdhënëse për arsimin e përgjithshëm dhe ato të lartë do të jenë këshillat mbi politikën e përgjithshme të kualifikimeve dhe prioritetet për zhvillimin e kualifikimeve në fushat e tyre përkatëse;
3. Përgjegjësitë e AKK do të jenë:
- Të dizajnojnë dhe zbatojnë Kornizën kombëtare të Kualifikimeve;
 - Të miratojnë kualifikimet dhe standardet, të parashtruara nga organet e caktuara, përfshirë këtu komitetet e standardeve të themeluara për këtë qëllim;
 - Të miratojnë rregullimet e vlerësimit dhe certifikimit për çdo kualifikim të aprovuar;
 - Të aprovojë dhe monitorojë ofruesit e arsimit dhe aftësimin dhe organet tjera (ku është e përshtatshme të përfshihen punëdhënësit) për të kryer vlerësimin dhe certifikimin për kualifikimet e aprovuara;
 - Të kryejë verifikimin e jashtëm (sigurimin e kualitetit) të organeve të aprovuara për të kryer vlerësimin dhe certifikimin;
 - Të mirëmbajë të dhënat mbi kualifikimet e aprovuara dhe certifikatave të lëshuara;
 - Të përcaktojë njohjen dhe/ose i ekuivalencën me kualifikimet e huaja;
 - I merr në konsideratë ankesat nga kandidatët që kundërshtojnë vendimin mbi vlerësimin nga organet e aprovuara për kryerjen e vlerësimit dhe certifikimit.
4. Përgjegjësitë e komiteteve të standardeve për kualifikimet e arsimit të përgjithshëm dhe profesional do të jenë:
- Të jap këshilla AKK mbi çështjet e KKK brenda fushave të tyre, përfshirë nevojën për kualifikimet në nivele të ndryshme apo për profile të profesioneve të ndryshme ose për fushat e lëndëve të specializuara;
 - Të përcaktojë kërkesat mbi standardet dhe vlerësimin për kualifikimet në sektorët e tyre apo fushat e lëndëve;
 - Të rekomandojë kualifikimet për miratim nga ana e AKK;
5. Përgjegjësitë e organeve që janë të aprovuara të kryejnë vlerësimin dhe certifikimin do të jenë:
- Të regjistrojnë dhe fusë në lista kandidatët (“të rregullt” dhe “të parregullt”) për kualifikim;
 - Të identifikojë nevojat e mësimin dhe vlerësimit të kandidatit dhe të ofrojë mundësi të vlerësimit dhe përkrahje për kandidatin, përfshirë këtu mësimin paraprak dhe të arriturat;
 - Të vlerësojnë kandidatët dhe mirëmbaj të dhënat e kandidatëve të vlerësuar;
 - Të veprojnë me grumbullimin e kredive dhe sistemet e transferimit;
 - Të zbatojnë sistemet e verifikimit të brendshëm (sigurimin e cilësisë);
 - Të nxjerrë certifikata të vërtetuara nga AKK;
 - Të raportojë tek AKK mbi certifikatat e dhëna.

Neni 7 Autoriteti Kosovar i Kualifikimeve

Në bazë të komenteve më lartë, propozohet struktura institucionale e përgjithshme, e përkohshme në vazhdim:

Figura 2
Struktura e përgjithshme institucionale




Mendohet se me një strukturë të tillë institucionale, do të jenë së paku tri opsione kryesore të raportimit:

- AKK themelohet nga MASHT-i (në bashkëpunim me MPMS dhe ministrinë e tjera). Ky opsion ka mundësi të favorizohet nga MASHT-i, por MPMS dhe partnerët shoqëror do të kenë rezerva të mëdha rreth kësaj. Do të funksiononte më së miri nëse AKK do të financohej vetëm nga buxheti i MASHT;
- AKK themelohet në bazë që ofron raportim të përbashkët tek ministrinë e ndryshme. Kjo zgjidhje do të ishte gjithësesi e domosdoshme në rastin e sistemit të bashkëfinancimit. Me gjasë një aranzhim i tillë do të kërkonte nga ministrinë përkatëse të kenë një mekanizëm formal për pajtimin mbi prioritetet kryesore dhe zgjidhjen e mospajtimeve potenciale jashtë mbledhjeve të këshillit të AKK-së, në mënyrë që të ofrojë kornizë të qartë brenda së cilës do të punonte AKK;
- AKK themelohet nga një autoritet i lartë, me gjasë nga Zyra e Kryeministrit (ZKM). Kjo marrëveshje do të favorizohej nga disa anëtarë të grupit, megjithëse qëndron shumë larg nga qartësia nëse propozimi do të mirëpritet nga Qeveria.

Në mënyrë që të realizojmë funksionet e përshkruara në nenin 6 , AKK duhet të sigurojë një strukturë të komitetit me përfshirjen e të gjithë bartësve/faktorëve të përshtatshëm vendor. Në vazhdim është dhënë një ilustrim i asaj çka nevojitet:

Figura 3
Struktura e propozuar e komitetit të AKK



Grupi gjithashtu ka marrë parasysh strukturën e brendshme organizative që mund të jetë e nevojshme për një AKK funksional. Dy diagrame alternative të strukturës u hartuan, e para e bazuar në një strukturë funksionale dhe, e dyta sipas llojit të kualifikimit.

Figura 4
AKK me strukturë sipas bazës funksionale:





Figura 5
AKK me strukturë sipas llojit të kualifikimit



Nga të dyja, është pranuar se modeli i dytë (figura 4) pasqyron strukturën e MASHT-it dhe do të ofronte identifikim më të dallueshëm për kualifikimet e arsimit të përgjithshëm dhe profesional. Megjithatë, do të paraqiste një rrezik të vërtetë ose për shkak të papajtueshmërisë ose për shkak të dyfishimit të qasjes në mes të këtyre dyjave. Për më tepër, nuk ofron një ndarje të qartë të organizimit në mes të funksioneve të ndryshme. Në interes të shmangies së konflikteve të mundshme të interesit, është e dëshirueshme që funksioni i sigurimit të cilësisë të jetë prerazi i ndarë nga zhvillimi dhe aprovimi i kualifikimeve dhe gjithashtu (megjithëse më pak e rëndësishme), puna e standardeve të jetë e ndarë nga puna për kualifikime.

Në secilin model, është paraparë se AKK do të kërkojë personel fillestar, që do të ishte numri padyshim minimal, prej 27 personash, megjithëse vërehet se shumica e autoriteteve për kualifikime në shtetet e tjera kanë filluar me numër më të madh të personelit. Në modelin 1, 6 persona do të ishin të nevojshëm për divizionin e standardeve, 10 në kualifikime, 5 në sigurimin e cilësisë, 2 në hulumtim dhe zhvillim dhe 3 në financa dhe administratë plus drejtori. Në modelin 2, në divizionin e kualifikimeve për arsimin e përgjithshëm duhet të punojnë 11 persona e po ashtu edhe për atë të kualifikimeve profesionale 11 persona dhe 4 persona në financa dhe administratë (ku do të gjindet /vendoset njohja e kualifikimeve si një funksion i centralizuar), plus drejtori.

Është e njohur se financimi kryesor, përfshirë këtu edhe shpenzimet për paga, duhet të vijnë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Në rrethanat aktuale, në të cilat të gjitha pozitat e shërbyesve civil janë të ngrira, dihet se ekzistojnë shansa minimale apo nuk ka fare që të arrihet ndonjë marrëveshje me qeverinë që të krijohet ndonjë linjë buxhetore e re për të financuar emërimet shtesë. Për këtë arsye, rregullimet tranzicionale duhet të shqyrtohen me të gjitha ministritë e interesuara dhe organizatat bartëse, me qëllim të emërimit të personelit të AKK nëpërmes të mjeteve të grumbulluara të personave me hua të përkohshme nga punëdhësit e tyre të rregullt. Gjithashtu duhet të hulumtohet edhe bashkëfinancimi, duke bashkëpunuar me ministritë e tjera dhe organet e tjera të bartësve. Në një periudhë më të gjatë, disa nga postet brenda KKK mund të bëhen emërimet të përhershme. Të tjerat mund të plotësoheshin përmes ministrive dhe organizatave të bartësve të tjerë.

Parimi i bashkëfinancimit të pjesëshëm duhet të zbatohet sa më herët që është e mundur. Të ardhurat plotësuese mund të nxirren nëpërmjet pagesave për vlerësim dhe certifikim. Pagesat e tilla duhet të përmbushen nga çdonjëri që paguan për arsimin, aftësimin dhe certifikimin në fjalë, p.sh nga shteti, nga

punëdhënësit ose nga individët. Përkrahje ndaj shpenzimeve të organizimit dhe për ndihmë teknike për funksionimin e dy viteve të para duhet të kërkohet nga AER dhe donatorët e tjerë.

Neni 8

Aranzhimet për aprovimin dhe rregullimin e kualifikimeve

Siç është theksuar më lartë në nenin 4, grupi e ka peshuar mirë çështjen se a duhet AKK të JEP kualifikimet (p.sh. nxjerrë certifikatat) apo APROVOJË kualifikimet, të cilat do të certifikohen nga organet certifikuese.

Organet e mëparshme (p.sh. që kanë dhënë kualifikimet) jo vetëm që do të kërkojnë ndryshimin e legjislacionit ekzistues mbi arsimin por do të bëjnë centralizim edhe më të madh të funksionit të certifikimit, megjithëse kjo mund të justifikohet në relacion me transparencën dhe cilësinë.

Më vonë (p.sh. të miratuarit e kualifikimeve) nuk do të përfshin ndryshime aq të mëdha në praktikën ekzistuese, se ofrimi i certifikimit do të vazhdojë të ofrohet nga ofruesit e arsimit dhe aftësimin në pajtim me përvojën aktuale. Një alternativë tjetër është të themelohen organet për dhënien e certifikatave si organe të pavarura të arsimit të përgjithshëm dhe profesional në pajtim me modelin Irlandez, por kjo do të shtojë krijimin e organeve të reja e që për momentin kjo mund të jetë e vështirë të arrihet. Pra, nuk ekziston nevoja për një organ të ndarë për dhënien e certifikatave për arsimin e lartë, meqë universitetet kanë fuqinë ligjore të nxjerrin kualifikimet e tyre.

Për të gjitha këto arsye të përmendura, ekziston mendimi se zgjidhja më e mire momentalisht për AKK është të miratojë dhe rregullojë aranzhimet që çojnë drejt dhënies së kualifikimeve por jo në lëshimin e certifikatave.

Kjo kërkon që AKK të:

- Publikojë kriteret për dizajnin e kualifikimeve të niveleve të ndryshme dhe në fusha të ndryshme të kornizës dhe për kushtet që duhet të përmbushen nga organizatat që zhvillojnë kualifikimet dhe kryejnë vlerësimin dhe certifikimin. Më vonë do të përfshijë kërkesat për vlerësuesin e kualifikimeve;
- Themelojë dhe zbatojë procedurat transparente për organizatat që zhvillojnë kualifikimet për tu paraqitur ata për aprovim (akreditim);
- Themelojë dhe zbatojë procedurat transparente për aprovimin (licencimin) e organeve që kryejnë vlerësimin dhe certifikimin;
- Vendosë procedurat për monitorimin e zbatimit të kualifikimeve nga organet e aprovuara që kryejnë vlerësimin dhe certifikimin, përfshirë edhe procedurat e raportimit;
- Themelojë sistemet për kryerjen e verifikimit të jashtëm apo vlerësimin e drejtë;
- Themelojë bazën e të dhënave për: a) të gjitha kualifikimet e aprovuara, duke përfshirë kërkesat e plota në marrëdhënie me kërkesat e hyrjes, strukturën e kualifikimit dhe përbërjen, standardet dhe kërkesat e vlerësimit, b) të gjitha organizatat e aprovuara për të ofruar vlerësim dhe certifikim për secilin kualifikim, c) të gjithë kandidatët e certifikuar. Në rastin e bazës së të dhënave a), dhe b), informata duhet të jetë botërisht e hapur dhe e publikuar në internet. Rasti me c), informata do të hapet vetëm për rastet specifike dhe nën kushte të veçanta (p.sh. për konfirmim zyrtar të kualifikimeve të një personi, për qëllime të njohjes etj.);
- Themelojë rregullimet për rishikimin dhe rifreskimin periodik të kualifikimeve të aprovuara. Normalisht, këto duhet të jenë të lidhura me kërkesat për riaprovimin e skadimit të afatit të një periudhe të caktuar të aprovimit;
- Publikojë direktivat për një numër të çështjeve, përfshirë praktikën e vlerësimit, akreditimit të mësimin paraprak dhe të arriturave, sistemet e kredive etj.;
- Themelojë rregullat për përcaktimin e barasvlerës dhe njohjes së kualifikimeve të huaja në Kosovë;
- Aranzhimet për dëgjimin dhe identifikimin e ankesave nga kandidatët në lidhje me vendimet e diskutueshme të vlerësimit.

AKK duhet të paraqesë raportet vjetore tek MASHT-i, lidhur me aktivitetet e lartë përmendura.

Neni 9

Rregullimet për dhënien e certifikatave për kualifikimet dhe sigurimin e cilësisë

Siç u tha në nenet 4 dhe 5 më lartë, është paraparë që certifikimi do të vazhdojë të ofrohet nga bartësit e arsimit dhe aftësimin. Kërkesat e AKK duhet të caktohen dhe zbatohen nëpërmjet sistemit të licencimit. Licencimi do të jetë i veçantë për çdo kualifikim.

Kushtet minimale për përmbushjen e kërkesave do të përfshijnë:

- I tërë personeli që e realizon vlerësimin e kandidatëve për kualifikim duhet të ketë aftësim të duhur dhe në afate më të gjata, të jenë të kualifikuar dhe të regjistruar si vlerësues për profilin / fushën përkatëse. Aranzhimet e tilla do të caktohen nga AAK;
- Aranzhimet e caktuara për regjistrimin e kandidatëve, përfshirë kërkesat për pranim, aranzhimet për kandidatët e rregullt dhe të parregullt etj.
- Ofruesi duhet të jetë përgjegjës për zbatimin e sistemit të brendshëm për sigurimin e cilësisë së vlerësimit. Parim kryesor do të jetë koordinimi efikas për të siguruar pajtueshmërinë e brendshme të vendimeve për vlerësim nga vlerësuesit e ndryshëm dhe verifikimi i brendshëm i procesit të vlerësimit nga vlerësuesit, përveç atyre që janë aty për aty të përfshirë në vlerësimin e punës së kandidatit;
- Ofruesi të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e dokumenteve të vlerësimit dhe certifikimit dhe raportimin tek AKK;
- Ofruesi të sigurojë mjetet dhe plotësisht të bashkëpunojë me aranzhimet e verifikimit të jashtëm ose hulumtimet e veçanta që mund të bëhen nga AKK;
- Të gjitha certifikatat e dhëna do të kërkohej t'i përshtaten formatit të standardizuar dhe të kenë miratimin zyrtar të AKK;

Në parim, duhet të ketë angazhim për të ecur drejt strukturave të kualifikimeve modulare, për të mundësuar zhvillimin e sistemeve të akumulimit të kredive dhe transferimit në afate më të gjata.

Aranzhimet duhet të përfshijnë vlerësimin e dëshmisë së mësimin dhe të arriturave paraprake, nën direktivat që do të publikohen nga AKK.

KKK do të sigurojë një kornizë për zhvillimin, njohjen dhe certifikimin e kualifikimeve të bazuara mbi standardet e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave. Si e tillë duhet të formojë themelet e një kornize të cilësisë, komponentët e së cilës do të jenë standarde, realizim (përfshirë kurrikulin e aprovuar, ofruesit e licencuar, mësimdhënës dhe trajnerët aftësuar dhe të regjistruar, inspektimin) me cilësi të siguruar dhe sisteme të vlerësimit të standardizuara, të verifikuara në mënyrë të brendshme dhe të jashtme.

Kualifikimet do të ofrojnë provë të vlefshme se standardet, të njohura në nivelin kombëtar dhe të krahasueshme në nivelin ndërkombëtar, janë arritur. Ato do të dëshmojnë për vlerësimin e cilësisë së lartë dhe të pajtueshme të të arriturave të nxënësve. Korniza e shpreh vizionin e mësimin, që synon të përmirësojë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat nga perspektiva e individit, shoqërisë dhe punësimit.

Cilësia do të sigurohet nëpërmes:

- Aprovimit të aranzhimeve të standardeve, vlerësimit dhe certifikimit dhe licencimit të organeve që sigurojnë vlerësimin dhe licencimin nga AKK;
- Çmuarjes dhe aprovimit të të gjitha kualifikimeve nga AKK, që paraqiten për përfshirje në kornizë;
- Publikimi i kriterëve dhe udhëzimit të hollësishëm nga AKK, që mbulojnë të gjitha aspektet e zhvillimit dhe zbatimit të kualifikimeve;
- Monitorimi i jashtëm i organeve të vlerësimit dhe certifikimit nga AKK për pajtueshmëri me kërkesat dhe organizimi i hulumtimeve të veçanta, në raste kur ka dyshime për probleme me cilësinë. Kjo mund të çojë tek kërkesat për përmirësim, si një kusht për licencim të vazhdueshëm ose, në raste të rënda, tërheqja e licencave që veç janë dhënë;

- Verifikimi i jashtëm i sistemeve të vlerësimit, të operuara nga organet e vlerësimit dhe certifikimit nga AAK, e plotësuar me auditime periodike të cilësisë të mësimit sipas sektorit ose sipas lëndës;
- Verifikimi i brendshëm dhe vetë-monitorimi nga organet e vlerësimit dhe certifikimit të sistemeve të tyre të brendshme.

Të gjitha raportet e auditimit dhe hulumtimit të cilësisë do të publikohen në linjë me synimin e sigurimit të transparencës në të gjitha proceset e cilësisë.

Neni 10

Dimensioni i BE dhe ndërkombëtar

KKK duhet të jetë në pajtim me tetë nivelet e Kornizës Evropiane për Kualifikime (momentalisht në fazën e konsultimit me shtetet anëtare të BE), që i cakton parimet e përbashkëta dhe nivelet e standardizuara ndërkombëtare për krahasimin e kualifikimeve përgjatë kualifikimeve përgjatë tërë Evropës.

Për këtë arsye është e rëndësishme që::

- Hartimi dhe dizajni i KKK nga AKK në këshillim me ministritë përkatëse, partnerët shoqëror dhe bartësit e tjerë duhet të marrë parasysh draft kornizën e BE.;
- Lidhjet në mes të KKK dhe Kornizës Evropiane duhet të jenë transparente;
- AKK duhet të publikojë informata për të bërë të qartë krahasimin në mes të niveleve të KKK dhe niveleve të kornizës së BE.

Sistemet e zhvilluara nga AKK duhet të marrin parasysh aspektet e tjera të “acquis communautaire” të BE në fushën e kualifikimeve..

Këto duhet të përfshijnë komponentët e Europës, të themeluara nga Vendimi i Parlamentit Evropian Nr 2241/2004/EC dhe i përvetësuar nga Këshilli i BE më 15 dhjetor 2004, i cili ofron një kornizë të vetme transparente për kualifikimet dhe kompetencat. Kjo përfshin dy dokumente (Format e CV të Evropës dhe Pasaportën për gjuhë të Evropës), të cilat individët mund t'i plotësojnë vet dhe tre dokumente të tjera (the Europass CV format and the Europass Language Passport), të cilat duhet të lëshohen nga organizata kompetente, në këtë rast, AKK.

Ato gjithashtu do të përfshijnë Sistemin Evropian për Transferimin e Kredive (SETK) për njohjen e periudhës së studimit jashtë vendit.

Kjo do të kontribuojë në mënyrë domethënëse për arritjen e objektivave të Deklaratës së Kopenhagës së datës 30 nëntor 2002, të cilën Kosova do ta mbështesë.

Përveç kësaj, njohja ndërkombëtare dhe nostrifikimi i certifikatave do të modifikohet për të marrë parasysh kërkesat e sistemeve për njohjen reciproke të diplomave dhe certifikatave nën të ashtuquajturën Sistemi i Përgjithshëm për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale, e dëshmuar nga Përvoja Profesionale dhe Sistemi i njohjes automatike të Kualifikimeve për Profesionet e veçanta të BE.

AKK do të jetë përgjegjës për hulumtimin e kërkesave të të lartpërmendurave dhe për raportim tek MASHT-i mbi ndërlidhimet e tyre për legjislacionin e ardhshëm apo reformës institucionale.

Aneksi 1

Anëtarët e Grupit të Dublini¹:

Nimon ALIMUSAJ Zëvendëskryesues i parë, i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte të Kuvendit të Kosovë

Hivzi DRAGIDELLA Shef i kabinetit, Oda Ekonomike e Kosovës (OEK)

Naser GRAJCEVCI Drejtor i Zhvillimit të Sektorit Privat, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Blerim HALITI Specialist për vetëpunësim, Ministria e Punës dhe Mirëqenies, Sociale(MPMS)

Dr. Enver . HOXHAI Kryesues, , i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë,Rini dhe Sporte të Kuvendit të Kosovës

Burim LECI Kryesues i Divizionit për Politikat e Rinisë, Ministria e Rinisë Kulturës dhe Sporteve (MRKS)

Vedat Macastena Projekt Menaxher, Observator për punësim dhe shkathtësi të Kosovës

Besim MUSTAFA Zyrtar për Koordinim dhe Projekte, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Jonuz SALIHAI Koordinator, Qendra e Arsimit e Kosovës (KEC)

Gazmend SELIMI Menaxher i punës/detyrës, Agjencioni Evropian i Rindërtimit (AER)

Zeqir SHKODRA Shef i Shërbimit Profesional, unioni i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK)

Abdurrahman SIMNICA Zyrtar i drejtimit të grafikës dhe arteve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Violeta SMAJLAJ Konsultante lokale, Programi i KOSVET-it BE

Fikrije ZYMBERI Zyrtare e drejtimit të Ekonomisë dhe Koordinatore e Kopenhagës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Aneksi 2

Workshop-i konsultues i palëve të interesuara të KKK , 13 korrik 2005

Nr.	Emri mbiemri	Institucioni	Kontakti
1.	Xhavit Rexhaj ✓	Drejtor i departamentit të arsimit të lartë(MASHT)	Xhavit. Rexhaj@ks-gov.net
2.	Agim Bërdynaj ✓	Drejtor i departamentit të arsimit parauniversitar (MASHT)	Agim. Bërdynaj@ks-gov.net
3.	Luljeta B.Demjaha	Shefe e sektorit të arsimit profesional (MASHT)	Luljeta .Demjaha@ks-gov.net
4.	Fikrije Zymberi ✓	Zyrtare e drejtimit të ekonomisë dhe koordinatore e Kopenhagës(MASHT)	Fikrije. Zymberi@ks-gov.net fikrijezymberi@yahoo.com
5.	Abdurrahman Simnica ✓	Zyrtar i drejtimit të grafikës dhe arteve (MASHT)	Abdurrahman. Simnica@ks-gov.net
6.	Besim Mustafa ✓	Zyrtar për koordinim dhe projekte (MASHT)	Besim .Mustafa@ks-gov.net
7.	Nazmi Caka ✓	Udhëheqës i njësisë për arsim të mesëm të lartë (MASHT)	Nazmi .Caka@ks-gov.net
8.	Nehar Shishko	Zyrtar për arsimin profesional	Neharshishko_@yahoo.com

		MASHT	
9.	Radica Berishaj	Zyrtare për arsimin tërëjetësor	Radical_berishaj@hotmail.com
10.	Blerim Haliti ✓	Specialist për vetëpunësim MPMS	Blerim_haliti@yahoo.com
11.	Anton Gojani ✓	Kryesues i divizionit për aftësi profesionale MPMS	Gojani_a@yahoo.com
12.	Vedat Macastena	Menaxher i projekt observator për punësim dhe aftësim	Esok2003@hotmail.com
13.	Naser Grajçevci ✓	Drejtor i departamentit për zhvillimin i sektorit privatMTI	Naser .Grajçevci@ks-gov.net
14.	Nol Buzhala ✓	Zyr. për zhvi. e politi. zhvi.MTI	Nol. Buzhala@ks-gov.net
15.	Hivzi Dragidella ✓	Shef i kabinetit,OEK	hivzid@hotmail.com
16.	Basri Jupolli ✓	Sekretar,OEK	m.ibrahimi@ipko.net
17.	Zeqir Shkodra ✓	Shef i shërbimit profesional,BSPK	bspk@etuc.org
18.	Jonuz Salihaj	Koordinator KEC	jsalihaj@kec-ks.org
19.	Axel Sachs ✓	Udhëheqës i projektit të GTZ	sachsah@yahoo.com
	Berta Hamza	Projekt asistente, GTZ	bertahamza@yahoo.de
20.	Gazmend Selimi ✓	Menaxher i punës AER	Gazmend.selimi@ear.eu.int
21.	Enver Hoxhaj ✓	Kryesues i komisionit për arsim,shkencë,teknologji,kulturë,rini dhe sporte	Enver.hoxhaj@assembly- kosova.org
22.	Nimon Alimusaj ✓	Zëvendëskryesues i komisionit për arsim,shkencë,teknologji,kulturë,rini	Nimon. Alimusaj@assembly- kosova.org
23.	Reijo Aholainen ✓	OSCE	Reijo.aholainen@osce.org
24.	Tzako Pantaleev	Këshilltar ndërkombëtar EAR KOSVET, Kuvendi i Kosovës	tzakop@yahoo.com
25.	David Handley	Udhëheqës i ekipit	David.handley@pem-consult.de
26.	Violeta Smajlaj ✓	Konsultante lokale Programi i Kosvetit-it BE KOSVET	violetasmajlaj@hotmail.com